



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:162400

Datë: 25.09.2024

Numri i dokumentit: 06210326

Ac.nr.3300/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Naime Ahmeti, kryetare e kolegjit, Bujar Muzaqi dhe Halide Reka, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses J.S. nga Gjilani, Rr. "...", nr..., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson K.A.S., avokate nga Gjilani, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson B.M., zyrtar ligjor tek e paditura, me objekt të kontestit kompensim i ushqimit për ditët e pranisë në punë, dhe kualifikimit, duke vendosur përkitazi me ankesën e të paditurës, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.962/2022 të datës 12.04.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur më 25.09.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

Refuzohet e pathemeltë ankesa e të paditurës Komuna e Gjilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.962/2022 të datës 12.04.2022, vërtetohet.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr. 962/2022 të datës 12.04.2022, në pikën një të dispozitivit ka aprovuar në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditëses J.S. nga Gjilani, rr..., nr..., dhe ka detyruar të paditurën komuna e Gjilanit–Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses për kërkesën për kompensimin e diferencës në pagë me licencim-me kualifikim fakultet, për periudhën kohore nga data 01.07.2018 e deri më datë 30.06.2021, t’ia paguaj shumën prej 1.992.60 euro, si dhe për kërkesën për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit, për periudhën kohore nga data 14.09.2020 e deri më datë 18.03.2022, për 311 ditë pune, t’ia paguaj shumën prej 622 euro, apo shumën e përgjithshme prej 2.614.60 euro, me kamatë ligjore 8% nga dita e parashtrimit të padisë, e deri në pagesën definitive, e të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë. Në pikën dy, ka detyruar të paditurën Komuna e Gjilanit–Drejtoria e Arsimit, që paditëses J.S., nga Gjilani, rr..., nr..., t’ia paguaj shpenzimet e procedurës, edhe atë: 104 euro për përpilimin e padisë nga avokatja, 41 euro për pagesën e taksës gjyqësore për padinë e parashtruar, si dhe 135 euro për

përfaqësimin e paditësit nga avokatja për një seancë gjyqësore, apo shumën e përgjithshme prej 280 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit më dhunë.

Kundër këtij aktgjykimi, e paditura në afat ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim Gjykatës së Apelit të Kosovës, ta aprovoj si të bazuar ankesën e të paditurës, të prish aktgjykimin C.nr.962/21 të datës 12.04.2022, dhe refuzoj padinë e paditëses apo ta prish aktgjykimin e atakuar dhe çështjen t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e pathemeltë

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, përmes të autorizuarës së saj, kundër të paditurës, ka parashtruar padi, për kompensimin e ushqimit gjatë ditëve të punës (shujtave) dhe kualifikimit, të precizuar në seancën e datës 06.04.2022, duke kërkuar që të aprovohet kërkesëpadija ashtu që të detyrohet e paditura që paditëses t'ia paguaj shumat si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar. E paditura, me anë të përgjigjes në padi, ka kontestuar kërkesëpadinë e paditëses, duke propozuar që e njëjta të refuzohet në tërësi si e pa bazuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqës si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.962/21 të datës 12.04.2022, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimin të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se për palët ndërgjyqës nuk ishte kontestuese se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura si mësimdhënëse, sikur që nuk kanë qenë kontestuese pothuajse të gjitha provat e prezantuara nga paditësja andaj edhe e njëjta e ka bërë të besueshme dhe të themeltë kërkesëpadinë e saj. Tutje, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se baza juridike e padisë ka rezultuar të jetë e bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 18.04.2017 dhe datës 21.01.2021, me anë të së cilave në mes tjerash punëdhënësi, sipas nenit 35 par.7 të Kontratës, obligohet që punëmarrësve tu sigurojë shpenzimet e ushqimit, ndërsa sipas nenit 7 të kontratës parashihet kualifikimi- gradimi shkollor andaj, për këto arsye gjykata ka vendosur që të aprovojë kërkesëpadinë dhe të obligojë të paditurën që paditëses t'i kompensojë shumat e përshkruara si në dispozitiv të aktgjykimin të ankimuar.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i

përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë e ka vërtetuar gjendjen faktike, se nuk është kontestuese në mes palëve se paditësja është e punësuar në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët “Thimi Mitko”, ku ende vazhdon të jetë në të njëjtën pozitë të punës tek e paditura dhe se kjo e fundit, në shkollën ku paditësja është e punësuar, nuk ka kushte të ofrimit të ushqimit në punë përmes restorantit, kuzhinës apo ndonjë formë tjetër, ndërsa nga provat e bashkangjitura është vërtetuar se paditësja i nga data 14.09.2020 e deri me datën 18.03.2022, ka gjithsej 311 ditë të pranisë në punë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, për arsye se duke u bazuar në nenin 35 par.7, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e cila ka hyrë në fuqi me datën 18.04.2017 dhe datës 21.01.2021, përcaktohet se *“Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim, gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro, për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim”*. Në rastin konkret, duke pasur parasysh se nga gjendja faktike e vërtetuar del se paditësja ka realizuar ditët e punës siç janë të theksua më lart, gjë që u vërtetua sipas vërtetimit të lëshuara nga Shkolla e Mesme të Ulët në “Thimi Mitko”, ndërsa e paditura nuk ka mundësi të ofrojë ushqimin përmes restorantit, kuzhinës apo në ndonjë formë tjetër, atëherë mbi bazën e të lartcekurave, kjo gjykatë gjeti se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses si të bazuar, duke i’ a njohur shumëat përkatëse të kompensimit për ushqimin gjatë ditëve të pranisë në punë, andaj edhe vendosi që të njëjtin ta vërtetoj sikurse në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit gjen se nga shkresat e lëndës provohet fakti se paditëses me aktvendimin mbi licensimin e mësimdhënësit të lëshuar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, me nr. 100000878 i është pranuar kërkesa për licensim, ndërsa me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.01/33, të datës 29.08.2008 në pikën 1 ka vendosur që: *“Nga 1 shtatori i vitit 2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët*

*profesional në shkollat e Republikës së Kosovës do të kenë rritje të pagave në bazë të kriterëve të licensimit”, ndërsa pika 4 ka përcaktuar se: “Mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional të pajisur: 1) Me diplomë të shkollës normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10%; 2) Me diplomë të shkollës së lartë pedagogjike përfitojnë ngritje të pagë bazë prej 19% 3) Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27%, 4) Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%”. Nga provat që gjenden në shkresat e lëndës vërtetohet fakti se paditësja ka diplomë universitare, ku edhe ka marrë titullin bachelor.*

Në rastin konkret, Gjykata e Apelit vlerëson se drejtë është vendosur kur paditëses i është aprovuar kërkesëpapia edhe lidhur me kompensimin e diferencës në pagë në emër të licensimit, ani pse gjykata e shkallës së parë është thirrur se kjo e drejtë është përcaktuar me Kontratën Kolektive të Arsimit, kjo Gjykatë vlerëson se kjo e drejtë nuk derivon nga Kontrata Kolektive e Arsimit edhe pse është e përcaktuar me të. Ky përfundim i Gjykatës së Apelit, vie edhe nga *Mendimi Juridik i Gjykatës Supreme të Kosovës, G.J.A-Su.A, 214/2023, i datës 05.10.2023*, ku është përcaktuar se për kërkesa e mësimdhënësve për kompensim mbi bazën e kualifikimit (licensimit) kompensimi bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.01/33, i datës 29.08.2008. Pra vendimi i Qeverisë së RKS, ka qenë në fuqi deri me datën 06.02.2023, kur edhe është shfuqizuar, dhe ky vendim është zbatuar që nga dita e nënshkrimit e deri në momentin kur ka qenë në fuqi, dhe se e paditura duke vepruar në kundërshtim me këtë vendim i’ a ka mohuar paditëses një të drejtë që i ka takuar.

Lidhur me pretendimin ankimor të të paditurës se kemi parashkrim sepse Kontratës Kolektive ka qenë në fuqi deri me datën 18.04.2020, Gjykata ankimore një pretendim të tillë nuk mund ta pranoj si të bazuar, pasi që duke u bazuar në dispozitën e nenit 45 të Kontratës Kolektive, ku është përcaktuar se: *“Nga Kontrata Kolektive palët mund të tërhiqen tre (3) muaj para skadimit të vlefshmërisë së saj, përmes letrës rekomanduese, e cila tërheqje fillon së zbatuari ditën e nënshkrimit të kontratës së re. Nëse nga Kontrata Kolektive pasi t’i skadojë afati i përcaktuar, nuk tërhiqet asnjëra nga palët, zbatimi i saj vazhdon edhe për një vit ...”*. Në rastin konkret, nuk është bërë tërheqja e Kontratës dhe se e njëjta ka vazhduar zbatimin edhe për një vit, saktësisht deri kur është bërë nënshkrimi i Kontratës Kolektive me 22.01.2021, ndërsa edhe me kontratën e re është paraparë kompensimi i ushqimit për ditët e pranisë në punë. Ndërsa sa i përket pretendimit për parashkrim, Gjykata e Apelit gjeti se ky pretendim nuk qëndron, pasi që kërkesa për kompensimin e ushqimit dhe kualifikimit e paditëses nuk është përfshirë në parashkrim, për faktin paditësja me datën 22.07.2021, ka paraqitur padi përmes të cilës ka kërkuar kompensimin kualifikimit nga data 01.07.2018 deri me 30.06.2021, nga çka rezulton se nga fillimi i periudhën për të cilën kërkohet kompensimi e deri te paraqitja e padisë nuk kanë kaluar më shumë se tri vite, që do të thotë se papia e paditëses nuk është e parashkruar konform nenit 87 të Ligjit të Punës.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo konsideroi se të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të gjitha arsyet e cekura në arsyetim të këtij aktgjykimi të shkallës së dytë, Gjykatës së Apelit i rezulton se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, andaj në mbështetje të dispozitave nga nenet 194, 195, paragrafi 1, pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**

Ac.nr.3300/2022, me datë 25.09.2024

Kryetare e kolegjit  
Naime Ahmeti, d.v.